



Thirrje për krijimin e një liste referimi të ekspertëve për përgatitjen e Vlerësimeve PEFA në 10 komuna

Shoqata e Punonjësve Financiarë të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike (ZFR) merr pjesë në zbatimin e aktiviteteve të projektit "Fuqizimi i Këshillave Komunale - Faza 2", (Empowering Municipal Councils – Phase 2), financuar nga Qeveria Zvicerane, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, dhe bashkëfinancuar e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara - UNDP.

Brenda aktiviteteve të projektit, ZFR duhet të përgatisë një rivlerësim PEFA për grupin e parë prej 10 komunave - partnere të projektit. Për këtë qëllim, nevojiten 5 (pesë) **ekspertë të Tipit A - ekspertë nga fusha shkencore, ekspertë të pavarur**; të cilët do të përgatisin një vlerësim PEFA në periudhën Mars - Qershor të vitit 2026.

Për nevojat e projektit, ekspertët do të kryejnë aktivitetet e tyre përmes punës në zyrë dhe në terren. Detajet e angazhimit janë përcaktuar në Përshkrimin e detajuar të detyrave të punës (ToR) për **Ekspertët - Tipi A** për përgatitjen e Vlerësimeve PEFA..

Tabela: Përshkrimi i detyrave të punës (ToR), për Ekspertët – Tipi A për përgatitjen e Vlerësimeve PEFA në 10 komuna

Përshkrimi i detyrave të punës
Takime Koordinuese të Ekipit PEFA (para fillimit të hulumtimit)
Përshtatja e Modelit PEFA
Përgatitja e materialeve të hulumtimit
Intervista / Vizita në Terren për PEFA në 10 komuna
Përpunimi i materialeve dhe informacioneve të hulumtimit
Përgatitja e një draft versioni të hulumtimit për 10 komuna
Takim koordinues për të shqyrtuar Draft versionet dhe për të përcaktuar versionet përfundimtare të hulumtimeve për 10 komuna
Përgatitja e versioneve përfundimtare të hulumtimeve
Përgatitja e një raporti integral
Përgatitja e raporteve krahasuese

Ekspertët inkurajohen të aplikojnë për këtë thirrje.

Pas përzgjedhjes së ekspertëve, do të kompletohet lista referuese e ekspertëve për përgatitjen e Vlerësimeve PEFA në 10 komuna.

Shoqata e Punonjësve Financiarë të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike (ZFR), duke ndjekur dinamikën e zbatimit të aktiviteteve të projektit dhe nevojat për ekspertizë, do të lidhë marrëveshje individuale me ekspertët e përzgjedhur, në të cilat do të specifikohen lloji, dinamika dhe vëllimi i angazhimit, si dhe shuma maksimale e kompensimit për angazhimin.

Shënim: Për këtë thirrje nuk janë të pranueshëm ekspertët me status të nëpunësve shtetërorë, publikë dhe administrativë që janë na marrëdhënie pune në organet shtetërore dhe në pushtetin lokal si dhe në organe të tjera shtetërore të themeluara në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, si dhe në institucione që kryejnë veprimtari me interes publik të përcaktuara me ligj, dhe të organizuara si agjenci, fonde, institucione publike dhe ndërmarrje publike të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit, si dhe nga komunat në Qytetin e Shkupit.

Nëse jeni të interesuar, ju lutemi të dërgoni një letër të shkurtër motivimi dhe CV-në tuaj të përditësuar me një foto jo më vonë se në orën 16:00 të premten më 13 mars të vitit 2026, në adresën e mëposhtme të email-it: zfr.emc2@gmail.com